

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
KRYETARI

URDHËR

Nr. 1979, datë 27. 3 .2023

**“PËR
CAKTIMIN E VENDEVE PUBLIKE PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE
PROPAGANDISTIKE E EDUKUESE DHE RREGULLAT PËR AFISHIMIN E
TYRE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14. 05. 2023”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nenit 64, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 79 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar si dhe të udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, datë 15.05.2023.

URDHËROJ

1. Pranë zyrave dhe ambjenteve të çdo njësie administrative/ lagjeve të Bashkisë Tiranë, kryhet afishimi i materialeve edukative zgjedhore, në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar zgjedhor.
2. Materialet propagandistike zgjedhore të afishohen deri në një distancë prej 5 (pesë) metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës, jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve.
3. Me mbarimin e fushatës zgjedhore, subjektet zgjedhore të marrim masat për heqjen e të gjithë materialeve propagandistike. Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit merr masa për zbatimin e këtij parashikimi nga subjektet zgjedhore.
4. Pas marrjes së informacionit nga subjektet zgjedhore për adresat e sakta të zyrave elektorale, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile në Koordinim me Njësitë Administrative/ Lagjet, brenda 5 ditëve të bëjë verifikimin e vendndodhjes së zyrave elektorale dhe të sigurohet për respektimin e dispozitave të udhëzimit nr. 6, 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për afishimin e materialeve propagandistike.
5. Policia Bashkiake dhe Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit të marrë masa të menjëhershme për heqjen e të gjitha materialeve propagandistike të afishuara në kundërshtim me këtë urdhër dhe kriteret e përcaktuara në udhëzimin përkatës të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë për publikimin e këtij urdhëri në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë.

7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile në Koordinimin me Njësitë Administrative/ Lagjet e Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë, Policia Bashkiake dhe Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Erion Veliaj

